




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Gjilanit, Nr. 03/2021, neni 4 si dhe vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01 Nr. 016-35201 i datës : 31.03.2022, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan shpall :

K O N K U R S PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË GJILANIT

Sipas këtij konkursi, ndahen dyqind e tetëdhjetë e nëntë (289) bursa për studentët e Komunës së Gjilanit, për vitin akademik 2021/2022 (për afatin kohor : 01.09.2021 deri më : 30.06.2022).

- Njëqind e shtatëdhjetë e dy (172) bursa në vlerë prej 600 euro (për dhjetë muaj nga 60 euro), për studentët e studimeve themelore të Komunës së Gjilanit të cilët studiojnë në Universitetet e Kosovës, jashtë Komunës së Gjilanit;
- Nëntëdhjetë e tetë (98) bursa në vlerë prej 400 euro (për dhjetë muaj nga 40 euro), për studentët e studimeve themelore të Komunës së Gjilanit, të cilët studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.
- Nëntëmbëdhjetë (19) bursa në vlerë prej 400 euro (për dhjetë muaj nga 40 euro), ndahen për studentët e studimeve Master.

Kriteret e Përgjithshme dhe të veçanta për të fituar bursën:

- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit;
- Shfrytëzues të bursave studentore mund të jenë vetëm studentët e rregullt;
- Shfrytëzues të bursave studentore mund të jenë vetëm studentët e rregullt me notë mesatare nga 7.0;
- Bursat do të ndahen vetëm për studentët që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve;
- Nuk mund të jenë përfitues të bursës më shumë se një student (aplikues) nga familja e ngushtë.

Kriteret e veçanta për të fituar bursën dhe poentimi :

- Studentët të cilët studiojnë në Universitetet Publike1 pikë
- Nota mesatare - poentimi bëhet mbi bazën e notës mesatare.....
- Studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorëve dhe veteraneve të UÇK-së.....1 pikë
- Familjet që kanë tre (3) studentë e më tepër të rregullt1 pikë
- Studentët me gjendje të vështirë ekonomike.....1 pikë
- Studenti/ja i cili nuk i ka dy prindërit në jetë.....2 pikë
- Studenti/ja i cili nuk e ka njërin nga prindërit në jetë.....1 pikë

Dokumentet e Nevojshme për Aplikim:

- 1.Certifikata e notave (origjinale);
- 2.Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
- 3.Kopja e letërnjoftimit;
- 4.Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik , i/e rregullt;
- 5.Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë i dëshmorit/es apo veteranit të UÇK-së;
- 6.Dëshmi se familja i ka 3 studentë në studime të rregullta;
- 7.Dëshmi për gjendjen e vështirë ekonomike (vërtetimi i asistencës sociale apo ndonjë dëshmi tjetër për gjendjen e vështirë ekonomike);
- 8.Dëshmi se studenti/ja nuk i ka dy prindërit apo njërin në jetë.
- 9.Kopjen e xhirologarisë bankare e konfirmuar nga banka përkatëse.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb faqen e Komunës si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Të gjithë studentët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara me dëshmitë e kërkuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në kuadër të Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme në Gjilan.



Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Selvete Sylejmani